

KOMUNIKIMI POETIK MBI JETËN

Krijimtaria e deritanishme poetike e poetit Gjek Marinaj, i cili jeton në Amerikë, përfaqësohet me dy vëllime poetike: "Mos më ik larg" (1995) dhe "Infinit" (2000). Vëllimi poetik "Infinit" i Marinajt sjell freski shkrimi me nota lirike. Është një lirikë e fuqishme, e cila shpalos gjithë patosin e tij dhe fatin e largimit nga atdheu, duke ndjerë një tension të fuqishëm shpirtëror e dramatik të përmallimit të tij për atdhe.

Poezia e Marinajt është autentike, është mishërim i invencionit, i mundësive infinite të sintezave asociative, i gërshëtimit të natyrave të ndryshme të të shprehurit, elementet diskursive me imagjinatën e frytshme dhe të pafundshme.

Libri "Infinit" i është i ndarë në 6 cikle, që krijojnë një strukturë: "Cili nga ne jam unë", "Kur poeti dëshiron të mos jetë poet", "Infinit", "Zero qetësi", "Fytyrat e njerëzve që dua" dhe "Bota nuk është tërësisht e bukur".

Librit i paraprin një parathënie e shkruar nga publicisti Agron Tufa, i cili duke vlerësuar vargun e Marinajt, thotë se kjo është një poezi e përmbajtur, jo sentimentale, prirë për nga plastika e formës, porse jo nga ekspresioni subjektiv i gjendjes, kërkon qartësi lëndore, kur i referohet një objekti dhe fton më shumë tek arsyeja sesa përjetimi i përkorë, me saktë, të përjetimi i arsyes së vetë ndenjes. Nërkaq, kritiku Prend Buzhala për këtë vëllimin poetik shprehet se Marinaj nuk do të bëjë pjesë në radhën e poetëve që i "zhgënjën" koha e sotme pas idealeve të përmbysura për një shoqëri të drejtë e as në mesin e të "zhgënjyerve" për përmbysjen e së djeshmes. Ai do ta shquajë, megjithatë, tonin dramatik të ekzistimit të dhembjes, të përsiatjeve, të gërmimeve lirike-refleksive në socialën, sepse socialja, siç do të thoshin dijetarët e moçem antikë, përbëjnë thelbin e letërsisë, se pse letërsia përfshin brenda veprës një botë të vlerave e të shprehive gjuhësore-ligjerimore, sikundër nënvizojnë mendimtarët e mëvonshëm. Te libri "Infinit" është arritur të shkrihet biografia e poetit. Cikli "Cili nga ne jam unë", përbëhet nga lirikë e dashurisë, ku shihet qartë se në varg shpalohet qartë etinerari i rrugës së përjetimeve dhe e observimeve nga një këndvështrim shumë i ngushtë i poetit. Mirëpo, ironia që del pikërisht nga një shkrim lirik i këtij poetit, nganjëherë duket se rebeluese dhe merr kuptim të vërtetë të protestës. Kjo temë, me fjalë të tjera merr një rrjedhë të tregimit të saj nga aspekti jo vetëm i euforisë së frymëzimit poetik, ose nga ndonjë zhgënjim tjetër. Ky varg është i qartë. Poeti shpalos gjithë ato dufin që i qëndron mbërthyer brenda qenies së tij.

Larg teje

*Isha si njeriu larg syzeve të tij optike
Ngjyrt e universit më ngjanin
Po aq të lodhura sa unë...*

(Një ditë të pashë me detin, fq. 30)

Në ciklin, Kur poeti të shiron të mos jetë poet, portretizohen figura dhe shembëlltura të përvojës së historisë, të artit, të letërsisë etj. Pra, këtu përfshihen kryesisht poezi përkush-



timore, si A. Shkrelit, P. Grudës, Van Gogut etj., me të cilin varg mëton të rikujtojë një dialog poetik dhe njëkohësisht t'i realizojë kujtimet dhe përjetimet e tyre përmes vizioneve më të ndritura duke i vënë ato shpeshherë edhe për brenda funksionit realizues poetik. Poezitë me këtë tematikë i shquan për brenda funksionit realizues poetik, si dhe toni i ngrohtë e përmallues. Në to kërkohet frymëzimi si sintezë e ndjenjave dhe ideve. Prandaj, konstatojmë, se Marinaj është poet i cili i këndon lirisë shpirtërore dhe historike të njeriut të trollit të tij. Në varg ai derdh botën e tij, që nëpërmjet tij të qesë në hapësirë gjithë dashurinë që i shkakton dramaë e trazimi për tokën e njerëzit, të cilët shkrinë veten për të.

*Diçka enigmatike u lakua rreth
shpirtit tënd*

*Si një litar i zjarrtë vetëtime
Dhe të vendosi si simbol i shenjtë
diku midis nesh dhe Qiellit.*

*Ju u larguat, poet i dashur, si një
britmë e trishtë...*

*Me largimin tuaj gjithësisht na tkurr
në përmasë e varrit...*

(Epitaf Azem Shrelit, fq. 52)

Poeti jeton dhe vepron tej Atlantikut. Te ai ndjenja e mallit për vendlindjen, për shtëpinë e tij të vjetër rri përherë e ndezur dhe çdo ditë e më tepër ai zjarr i mallit i zgjohet peshë.

*Shtëpia ime ku kam lindur në Brrut,
Kujtimet e rritjes më stërpikën në
fyturë*

Si qumësh poetik që vetëm unë mjel...

(Shtëpia në Brrut, fq. 57)

Në ciklin "Infinit" poeti prezantohet me poezi refleksive. Poezitë e kapërthyer në këtë cikël ngërthen në vete një filozofi të thellë bashkë me mesazhin dhe porosinë. Filozofia e jetës këtu mbetet si teoremë në infinit.

Kosova është ajo dhembja e përbashkët universal dhe kombëtare. Te cikli Zero qetësi, kryesisht hasim

poezi që i kushtohen Kosovës bashkë me dhimbjet që kishte, si Kosova në 1999, në Kosovë, mëngjes i mje-gullt, të Kosovës në Prishtinë etj.

Në Prishtinë

*Netët e errëta e humbën betejën,
Ato po largohen duke mërmëritur.
Tani në vend të tyre, thjesht,*

Ditët marrin mbrëmjeve një sy gjumë.

(Në Prishtinë, fq. 94)

Ndërkaq, ama e frymëzimit të poetit është në atdhe. Te cikli, fytyrat e njerëzve që dua, hasim vargje kryesisht që i kushtohen atdheut të tij, Shqipërisë. Poeti jeton larg atdheut të tij, mirëpo shpirtin përherë e dërgon në atdhe. Janë këto poezi që i japin dritë, i japin jetë këtij libri.

*Sonte do shkas tinëzish nga gjumi
Me maskën e embël të një ëndrre
në fyturë.*

*Të lutem, kështu bënë edhe ti,
Shqipëria ime-
Fryma me të cilën e fryjë flautës së
jetës*

*Tek nxirrje tinguj të dashuruar
mundimesh.*

(Shqipëria, fq. 98)

Një udhëpërshkrim planetar poetik tek vargjet të këtij poeti hasim në ciklin e fundit "Bota nuk është tërësisht e bukur".

Librin "Infinit" e botoi ShB "Marinaj Publishing", Dallas, SHBA, 2000. /Mikel Gojani



AUTOBIOGRAFIA

Xhevdet Xhafa është njëri nga piktorët tanë më të frytshëm. Ai i takon grupit të piktorëve të vjetër, të cilët i vunë themelet e artit figurativ të ne.

Ky doajen i piktures sonë mbeti i veçantë, duke ngërthyer gjithnjë në vete rezonancën e nivelit më të lartë. Pikturat e tij rrezatojnë rrëmishëm në psikën tonë si një simbiozë autoktone. Në të vërtetë, është i njohur për pikturat abstrakte, me elemente të kolazhit, të materializuara me elemente të veshjeve dhe stolive nga arti popullor autokton. Ky art i tij është mjeshtërisht i bukur, meqë në të ngërthehet një autoktonizëm i mirëfilltë. Kjo brengë e tij është fare vetjake. Arti i tij i bukur, pamëdyshje, e sfidon mendjen në procese rrëfimi. Ky rrëfim dhe kjo simbiozë autoktone është një filozofi e mirëfilltë për të vërtetën, jetën dhe botën. Në këtë aspekt, ky urtak i pasionuar dhe ky intelektual i rafinuar, në shpirtëroren e vet ka aq shumë dashuri për artin tonë popullor sa ansjë piktor tjetër yni.

Ky doajen i mirëfilltë, i cili ka një themel të fortë si artist i rezonuar, është gjithnjë në dialog me këtë formë të krijimtarisë. Deri më sot, asnjë piktor ndër ne nuk i mbeti më tepër besnik këtij arti autokton sesa Xh. Xhafa. Dhe, lirisht mund të themi se Xhafa mbeti individualitet i veçantë. Rrobat e njeriut, gjësendet, lecat dhe gjësendet tjera janë të thurura dhe së bashku tregojnë veçantinë e artit burimor autokton. Piktura e tij është një dëshmi e vërtetë nga realiteti jetësor në kontekstin gjeografik, social dhe etnik.

Kjo "Autobiografi" është e Unit të tij, e ambientit të tij dhe është paraqitur me një invencion shumë të lartë. "Autobiografia" e tij është pa mëdyshje një reminiscencë etihukë me plot vuajtje, varfëri dhe katrahura të një "kataklizmi shpirtëror". Ajo është biografia e jonë. Kjo plotni e një idealizimi të lartë shpirtëror e ka në vete një nostalgji prekëse. Kjo nostalgji prekëse është një drithërimë e dhembjes

krenare. "Autobiografia" e tij është e brumosur me rrëmetin e kohës. E, ky rrëmeti i kohës është dialog i përhershëm i fizionimit të formave të një kompozicioni të lartë që tregojnë një shkallë shumë të lartë të krijimit imagjativ.

Xhevdet Xhafa me imagjinatën e stërholluar dallohet dukshëm nga piktorët e tjerë. Kjo qasje e tij bravuroze, për të na e prezentuar këtë art popullor të ravijëzuar tej-mase, e bëjnë piktor me një stil të veçantë rrëfimi.

Andaj, piktorat e tij, gjithnjë, ngacmojnë shpirtin dhe mendjen, njëkohësisht. Kjo mençuri dhe kjo plotni e ravijëzuar me një sensibilitet të stërholluar si piktor mbetën te ne si veçanti parësore për artin popullor.


Dhe, në këtë drejtim Xh.Xhafa, ky piktor madhor i piktures shqiptare la gjurmë të pashlyeshme të çdo ardashës me rezonancën dhe ravijëzimin e mirëfilltë autokton.

Edhe pse sot e gjithë ditën kemi shumë izma dhe rryma të tjera, Xhafa këtyre rrymave iu përgjigj me një rezervë të theksuar. Ai asesi nuk u takoi atyre. Në shpirtin e tij mbeti Uni i rafinuar i një sensibiliteti të rezonuar, mbeti ajo fshëhtësia e ruajtjes së artit popullor autokton.

E, pra, s'është kjo mençuria dhe sensibiliteti kombëtar? Rruga e trasuar është vetë Uni i tij. Identiteti i tij shpirtëror është i formësuar gjer në atë masë të formësimit vetjak, që sot qëndron si "Katakomb" në ruajtjen e këtij arti të bukur. Andaj, arti i tij i bukur gjithmon do të jetë i bukur. E, kjo bukuri e tij shembëllën gjithmon dhe gjithnjë.

Andaj, "Autobiografia" e tij mbeti biografi jona në përgjithësi. E, piktura e tij ravijëzon dhe rezonon gjithnjë gjer në përpikëri me imazhet e tij si porosi.

Mr. Bislim Aliu



"Autobiografia" e Xhevdet Xhafës